



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 15.10.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 11.10.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Rojet e Nderit" për aktivitetin: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 nxjerr:

VENDIM

1. **Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatori Ekonomike "Rojet e Nderit" e datës 15.10.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211 kundër *Njoftimit për Vendimin e Autoritetit Kontraktues* të datës 10.10.2019, të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. **Vërtetohet** *Njoftimi i Autoritetit Kontraktues* i publikuar me datë: 10.10.2019;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë respektimin e Vendimit të datës 10.10.2019
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik "" me datë 11.10.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Sigurimi i objekteve të Komunes së Prishtinës" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-3238-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 15.10.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës të pa bazuara për arsyet në vijim:

-Analiza financiare e paarqitur për orët e ditës nuk përkon me kërkesat e AK-se dhe as me Ligjin e Punës si që pretendon i njëjti, por duhet të jetë si vijon:

PER SHERBIMET GJATE DITES:

Paga bruto për muaj 250.00 €;

Oret e nates 0%;

Oret e vikendeve 50% që është 0,71 € për orë pune; dhe

Pushimi vjetor prej minimum 18 dite x 8 Ore pune = 144 Ore pune x 1.42 € = 204.50 € në vit.

204.50:12 muaj=17.04 €.

Paga totale per nje punetor ne muaj 250.00+0.71+17.04 = 267.75€

267.75 x 18%=48.19=315.95+12.50 € paga totale 328.45 per nje punetor. Bazuar ne pozitat

sipas pershkrimit te çmimit kemi 148 punetor me nderrim ditor x 328.45 €=48,610.60 € ne muaj x 36=1.749,981.16 €.

PER SHERBIMET GJATE NATES:

Paga 250.00 €;

Nje ore pune 250.00/176=1.42 €

Ora e nates 1.42 x 30%=0.426 qe d.t.th. 1.42+0.426=1.846

Ora e vikendit 1.42x50%=0.71 qe d.t.th. ora e festave 2.13 euro

Pushimi vjetor per nje punetor-204.50 ne vit. (17.04 per muaj)

Nga kjo rrjedh se paga totale per nderrime te nates per muaj eshte si vijon:

250 +17.04 +24.60x18%=291.64 qe d.t.th. paga totale per muaj 344.13 €, qe rrjedh se çmimi mujor eshte 344.13 x 72 punetor =24,777.73x36 muaj=891,998.42 €

Bazuar ne kete analize rrjedh se çmimi me i ulet qe pershin detyrimet ligjore eshte si vijon: 1.749.981.60+891,998.42 €=2 641,980.00 € duke pase parasysh vetem detyrimet ligjore pa kalkuluar shpenzimet dhe fitimin e kompanise.

Pra ne vleren qe ne e kemi parashikuar me plus 30%-2.730,000.00 € ka ekzistuar mundesia e kalkulimit te te gjitha detyrimeve dhe e fitimit te kompanise, ndersa çmimi juaj e tejkalon dukshem kete.

Nga kjo rrjedh se analiza juaj nuk eshte reale dhe eshte paraqitur per te arsyetuar kerkesen tuaj, por jo ne harmoni me kerkesat tona dhe te Ligjit te Punes.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne sqarimet e paraqitura më lartë dhe në sqarimet detale nga Vendimi për refuzim te rekomandimit per kontrate ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.

Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit